

VENDIM
Nr. 151, datë 18.9.2020

MBI ZGJATJEN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN E
KËRKESËS SË SHOQËRISË “LENGARICA & ENERGY” SHPK, NR. 306, SERIA FK15,
PËR RINOVIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE-s, NR. 105, DATË 18.8.2015

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 91 dhe 92, pika 1 dhe 2, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenit 4, pika 1, germa “d”; nenit 5, pika 1, germa “d”, dhe nenit 8, nenit 9, nenit 13, si dhe nenit 16, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, nenit 15, të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 18.9.2020, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 102/2 prot., datë 7.9.2020, e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes mbi kërkesën e shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.a., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 134, datë 10.8.2020, filloi procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në median e shkruar me shkresën nr. 62/22 prot., datë 11.8.2020 dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “Lengarica & Energy” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 947/1 prot., datë 13.8.2020, ERE iu drejtua shoqërisë duke i njoftuar fillimin e procedurës dhe kërkoi plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria “Lengarica & Energy” sh.p.k. me shkresën nr. 31 prot., datë 20.8.2020, protokolluar në ERE me nr. 974/2, datë 21.8.2020, ka përcjellë dokumentacionin e munguar me përjashtim të Sistemit IT dhe disponimit të zyrave të dedikuara për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Me shkresën nr. 974/3 prot., datë 28.8.2020, në bazë të nenit 11, të rregullores së licencimit iu kërkua shoqërisë të paraqesë në ERE vërtetimet e Gjykatës dhe Prokurorisë për vetë shoqërinë dhe për administratorin e saj edhe nga rrethi i Përmetit.

- Në përgjigje të sa kërkuar nga ERE, shoqëria “Lengarica & Energy” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 974/4 prot., datë 1.9.2020, dhe shkresës nr. 974/5 prot., datë 3.9.2020, ka përcjellë në ERE dokumentacionin e kërkuar.

- Në vijim të situatës së krijuar nga Covid-19, në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 133, datë 10.8.2020, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 51, datë 26.3.2020, ‘Mbi disa ndryshime të përkohshme në procedurat e licencimit në ushtrimin e veprimtarive në sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror, në kuadër të masave pas shfaqjes së virusit Covid-19 dhe shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në vendin tonë’”, është përcaktuar se afati për dorëzimin e një aplikimi për rinovim licence për të gjitha licencat që kanë përfunduar deri në 30 qershor 2020, është jo më vonë se data 1.9.2020.

- Aplikimi i shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k. rezulton i paraqitur në afat.
- Rezulton se shoqëria ka kryer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.
- Aplikimi i shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikim, transferim, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:
 - Formatimi dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
 - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7) është paraqitur dhe plotësuar pjesërisht.
- Mungon dokumentacioni i kërkuar sipas germës “e” (Sistemin IT të krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi).
- Mungon dokumentacioni i kërkuar sipas germës “g” (Dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve).
- Referuar dokumentacionit të depozituar nga shoqëria dhe informacionit të përcjellë për qëllime të këtij aplikimi rezulton e paqartë se si do të sigurohet energjia për ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit nga shoqëria aplikuese.
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 30 (tridhjetë) ditë kalendarike afatin e vendimmarrjes së ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë “Lengarica & Energy” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
 2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti